



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

3228
25.04.2025

Librazhd më: 25.04.2025

NJOFTIM

“PËR MBLEDHJEN E KËSHILLIT TË BASHKISË”

Z.znj. _____

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 53 pika 2 dhe pika 4, ju njoftojmë se ditën e **Mërkurë, datë 30.04.2025**, ora 10:00 do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak për muajin **Prill** 2025. Mbledhja do të zhvillohet te Pallati I Kulturës Sadi Halili kati II-të me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi I procesverbalit të mbledhjes së datës 26.03.2025.
3. **P/Vendim** “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha mars 2025”.
4. **P/Vendim** “Për miratimin e listës së projekteve prioritare në ifrastrukturën e bashkisë Librazhd për projekt buxhetin afatmesëm vitin 2026-2028”.
5. **P/Vendim** “Për miratimin e kalendarit të Konsultimeve Publike per draft Tavanet Buxhetore te Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028.
6. **Të ndryshme:**

- *Ditën e martë datë 29.04.2025 ora 10:00 të mblidhen Komisionet te Pallati Kulturës “Sadi Halili”.*

KRYETARI I KËSHILLIT
Mitat BIÇAKU



PROCESVERBAL

- I mbajtur sot më datë 26.03.2025 në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak Librazhd.
 - Pasi u lexua rendi i ditës nga Kryetari i Këshillit të gjithë të pranishmit janë dakort 18 vota pro.
 - Miratohet fillimi i mbledhjes me këtë rend dite si më poshtë vijon:
1. **P/Vendim** “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha shkurt 2025”.
 2. **P/Vendim** “Për miratimin e tavaneve përgatitore për projekt-buxhetin afatmesëm 2026-2028”
 3. **P/Vendim** “Miratimin e akt-marrveshjes nr.1377 datë 10.03.2025 “Për montimin e një ure metalike tip “Baily” në fshatin Polis Sheh,Njësia Administrative Polis ,Bashkia Librazhd”.
 4. **P/Vendim** “ Propozim për dhënien e Statusit Dëshmori I Atdheut të ndjerit Muharrem Hidri”
 5. **P/Vendim** “ Për caktim agjenti tatimor për vitin 2025”.
 6. **P/Vendim** “ Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin e banesave me kosto të ulët dhe subvencionimi i interesave të kredisë”.
 7. **P/Vendim** “ Për një ndryshim në vkb nr 116,date 27.12.2024, Për ngritjen e komisionit të strehimit”.
 8. **P/Vendim** “Mbi propozim për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve në pronësi të bashkisë dhe të Njësive në varësi të saj”

9. Të ndryshme:

Shënim: Largohen nga mbledhja katër këshilltarë të opozitës për arsye të një Peticioni Drejtuar Këshillit Bashkiak me titull “ Për mbrojtjen e interesave të banorëve të Hotolishtit në lidhje me ndërtimin e rrugës Elbasan Qafë-Thanë”.

- Kryetari i Këshillit Mitat Bicaku i sqaron në lidhje me këtë Peticion: Shqetësimi i banorëve të Hotolishtit është mëse i drejtë, ky shqetësim tashmë ka shkuar deri te Kryeministri i Shqipërisë dhe besojmë të gjithë që ky shqetësim do të marri një zgjidhje.Ku dhe vetë Zv/Kryeministrja znj.Belinda Balluku në inspektimin që kreu bashkë me Kryeministrin e ngriti si shqetësim ku tha që shumë shpejt do të bëjmë një takim me popullin e Hotolishtit dhe besoj se do të gjejmë gjuhën e përbashkët që ky shqetësim të marri zgjidhje.
- Kryetari i Këshillit Mitat Bicaku e merr fjalën: Vazhdojmë me rendin e ditës dhe mbas largimit të Grupit të Opozitës korumi i nevojshëm për fillimin e mbledhjes e kemi ku jemi të pranishëm **13 këshilltarë**.

Fillimi i mbledhjes:

P/Vendimi nr 1 “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 % periudha shkurt 2025”.

Këshilltari Ndriçim Doda e merr fjalën,kam një kërkesë në lidhje me specialistët e ndihmës ekonomike,duhet të shkojnë ta bëjnë verifikim në terren të familjes dhe jo cfarë nxjerr sistemi.

Të një mendimi janë dhe këshilltarët e pranishëm në mbledhje.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve **13 vota pro.**

P/Vendimi nr 2 “Për miratimin e tavaneve përgatitore për projekt-buxhetin afatmesëm 2026-2028”

Fjalën e merr Drejtoresha e Financës për të sqaruar këshilltarët në lidhje me këtë P/Vendim.

Përcaktimi i tavaneve përgatitore të shpenzimeve të PBA për vitet 2026-2028 është bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”në përputhje me nenin 4 dhe 24 të ligjit nr.9936,date 26.06.2008 Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.Kemi bërë një shpërndarje të detajuar në tablelat përkatëse bashkëlidhur p/vendimit dhe relacionin shpjegues.

Këshilltari Ndriçim Doda e merr fjalën.

A ndryshon tarifa për tokat bujqësore apo ngel e njëjtë?

Fjalën e merr Drejtoresha e Taksave dhe Tarifave Vendore Znj.Lindita Shuli për të sqaruar pyetjet e këshilltarëve.

Tarifa për tokat bujqësore nuk ndryshon dhe çmimi miratohet nga Ministria.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet me të gjitha votat e të pranishmëve 13 vota pro.

P/Vendimi nr 3 “Miratimin e akt-marrveshjes nr.1377 datë 10.03.2025 “Për montimin e një ure metalike tip “Baily” në fshatin Polis Sheh,Njësia Administrative Polis ,Bashkia Librazhd”.

Nuk ka pyetje nga këshilltarët.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve 13 vota pro.

P/Vendimi nr 4 “Propozim për dhënien e Statusit Dëshmori i Atdheut të ndjerit Muharrem Hidri”

Fjalën e merr këshilltari Kujtim Albrahimi.

Përderisa Komisioni përkatës e ka sjell për ta miratuar jemi pro këtij p/vendimi, shumë që këshilli bashkiak nderon këto figura.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve 13 vota pro.

P/Vendimi nr 5 “Për caktim agjenti tatimor për vitin 2025”.

Kryetari i Këshillit shpjegon këshilltarët në lidhje me këtë p/vendim;

Ky p/vendim nuk është miratura në mbledhjen e kaluar pasi masa e shpërblimit të agjentit tatimor ka qënë në 2% ,ku këshilltarët kanë qënë kundër të jetë 2% por të vazhdojë në masën 1% sic ka qënë dhe më pare.

Këshilltarët nuk kanë pyetje në lidhje me këtë p/vendim

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve 13 vota pro.

P/Vendimi nr 6 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin e banesave me kosto të ulët dhe subvencionimi i interesave të kredisë”.

Këshilltarja Adelina Alla e merr fjalën.

A me këto kushte do të përzgjidhen dhe fituesit? Dhe ku bëhen aplikimet?

Fjalën e merr Sekretari I Përgjithshëm Bajram Pishkashi për sqarimin e pyetjeve të bërë nga këshilltarët.

Në bazë të programeve në miratojmë gjithmonë kriteret bazë për përfitimin e këtyre programeve. Aplikimet bëhen në bashki tek Zyra e Strehimit dhe duhet të ketë sa më shumë aplikime.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve 13 vota pro.

P/Vendimi nr 7 “Për një ndryshim në vkb nr 116, date 27.12.2024, Për ngritjen e komisionit të strehimit”.

Kryetari i Këshillit shpjegon këshilltarët në lidhje me këtë p/vendim;

Në këtë p/vendim kemi vetëm zëvendësimin e Kryetarit të Komisionit pasi ka marrë një detyrë tjetër jashtë bashkisë.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve 13 vota pro.

P/Vendimi nr 8 “Mbi propozim për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve në pronësi të bashkisë dhe të Njësisë në varësi të saj”

Këshilltari Zenel Bahiti e merr fjalën.

A ka urdhër të titullarit në lidhje me këtë p/vendim ?

Kryetari i Këshillit e merr fjalën.

A merren masat e duhura për dëmtimin e këtyre materialeve ,pasi kemi prezent dhe Drejtorë ?

Fjalën e merr Drejtoresha për të sqaruar pyetjen e këshilltares.

Në lidhje me pyetjen e pare, urdhëri I Kryetarit të bashkisë del pasi vendimi është konfirmuar në Prfekturë dhe ngrihet dhe komisioni përkatës.

Këshilltarja Arjana Çekrezi e merr fjalën.

Grupi I Komisionit nga Bashkia gjithmonë ka ardhur dhe ka verifikuar të gjitha materialet që dalin jashtë përdorimit.Në shkollën ku unë jamë Drejtoreshë e kam bërë urdhër kush dëmton materialet e shkolles duhet ti paguaj vetë dëmtuesi.

Hidhet në votim ky P/Vendim; Miratohet më të gjitha votat e të pranishmëve 13 vota pro.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA



KRYETARI I KËSHILLIT
Mitat BICAKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NJËSIA ADMINISTRATIVE
NDIHMA EKONOMIKE DHE SHËRBIMET SOCIALE

PROJEKT-VENDIM

Nr.16 Datë 15.04.2025

Mbi dhënien e Ndhmës Ekonomike
nga fondi i Kushtezuar 6%
(Periudha: MARS 2025)

Në mbështetje të Ligjit Nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Vendim Nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndhmën Ekonomike” Kreu IV, Vendim Nr. 956, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e Ndhmës Ekonomike”

Nisur sa më lart nga verifikimi i sistemit elektronik i Ndhmës Ekonomike rezulton se janë refuzuar (që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme) 88 Familje, dhe propozohet:

- 1-Të përfitojnë Ndhmë Ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6% : Gjithsej 88 Familje me një fond: **378,855** lekë. Vlera e ndihmës **302,863** lekë, vlera e energjisë **75,992** lekë
- 2.Të mos përfitojnë për arsye të mos plotësimit të kriterëve nga fondi i kushtëzuar 6% nuk ka familje.
- 3.Familjet përfituese sipas listës bashkëngjitur.
- 4.Ngarkohen për zbatimin e këtij Projekt-Vendimi Administratorët Shoqërorë të Ndhmës Ekonomike në Njësitë Administrative.
- 5.Ky Projekt-Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së Vendimit

Përgjegjës në Sektorin e Ndhmës Ekonomike

Rexhep Shaka

**KRYETARI I BASHKISË
MARIGLEN DISHA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NJËSIA ADMINISTRATIVE
NDIHMA EKONOMIKE DHE SHËRBIMET SOCIALE

RELACION

Nr.16 datë 15.04.2025
Mbi Dhënien e Ndhmës Ekonomike
nga Fondi i Kushtëzuar 6%
(Periudha: MARS 2025)

Në mbështetje të Ligjit Nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Vendim Nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndhmën Ekonomike” percaktohet qarte se kush mund ta perfitoje kete ndihme nga fondi i kushtezuar 6% i bllok ndihmës ekonomike.

E rëndesishme është që familjet që nuk klasifikohen si përfituse në sistemin elektronik të ndihmës ekonomike me pikë të pa mjaftushme të verifikohen saktësisht nga Administratori Shoqërorë i Ndhmës Ekonomike duke e vlersuar nga ana ekonomike,sociale,shoqërore dhe duke pasur parasysh kriteret që janë miratuar në Këshillin Bashkiak ta vlersojë familjen nëse duhet apo jo që të klasifikohet si familje që duhet të përfitoje ndihmë ekonomike nga fondi 6%.

Nisur sa më lartë nga verifikimet në sistem dhe paraprakisht vlersimi social-ekonomik ne familje nga Administratori Shoqërorë, nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit 88 Familje dhe propozohet:

1-Të përfitojnë Ndhmë Ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6% Gjithsej 88 familje.

2- Te mos perfitojne nuk ka familje.

Njesitë Administrative:

1. Njësia Administrative Qytet	36 Familje me fond	140,121 lekë
2. Njësia Administrative Hotolisht	20 Familje me fond	104,958 lekë
3. Njësia Administrative Polis	11 Familje me fond	43,584 lekë
4. Njësia Administrative Qendër	13 Familje me fond	55,960 lekë
5. Njësia Administrative Orenjë	8 Familje me fond	34,232 lekë

Totali si Bashki 88 familje me fond 378,855 lekë

Relacion për Familjet e Refuzuara

- Familjet që nuk janë rekomanduar për tu trajtuar nga fondi 6 % nuk ka.

Përgjegjës në Sektorin e Ndhmës Ekonomike

Rexhep Shaka



Nr	Emri i Aplikantit	NID	Statusi aplikimit	Vlera e përlogaritur	Kompensimi i Energjisë	Totali	Numri
				për fondin 6%			anëtarëve
1	Xhemile Xhelo Alliu	G75616178K	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
2	Fatbardha Dalip Kurti	G45320047G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
3	Lefterije Selaudin Nogu	I85810017C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	7,920	1,288	9,208	3
4	Ramadan Hamit Hila	G80308080E	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
5	Sami Idriz Gançi	G40414066V	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
6	Eduart Xhevit Pali	I10524158W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,881	1,288	7,169	4
7	Xhemile Fehta Menalla	G95208071N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
8	Nazmi Hazis Sina	G10420107U	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
9	Vero Elmaz Duka	G30212084C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
10	Elenie Avni Hysa	J25120025R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,940	1,288	7,228	2
11	Mariglen Qazim Polisi	I80706027W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	4,792	1,288	6,080	3
12	Rabie Sadik Leka	G95628010G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
13	Muhamet Qazim Gega	G50501112O	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
14	Ymer Xhaferr Kala	G31020023L	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,049	1,288	4,337	3
15	Avni Reshit Stafa	H20620213J	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
16	Jonuz Shahin Çota	G30206013H	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703		3,703	3
17	Sabri Hajdar Stafa	G71012046N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
18	Lutfije Ali Roçi	E25406026F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
19	Shefqet Elmaz Laçka	G90720242L	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,227	1,288	6,515	3
20	Avni Beqir Bogdani	H00106009U	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,227	1,288	6,515	3
20	Total Njësia Administrative: Hotolisht			80,486	24,472	104,958	43
1	Dritan Nazmi Brahja	I30216010M	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
2	Iva Zini Shehu	J25701027C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,881		5,881	5
3	Shyqyrije Qazim Shpata	D66211004W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,049		3,049	2
4	Artur Musa Agastra	G10101021O	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
5	Shyqyrie Belul Blloshmi	G65107079J	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2

6	Tahire Qamil Balla	G35812017F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
7	Vule Kadri Topi	F75710021A	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
8	Farije Sefedin Topi	G05328025M	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
9	Qamil Selman Ferra	F80501032B	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
10	Olsi Nazmi Dosku	H50108018L	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
11	Fatmira Hysen Gjorga	G15420041E	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
12	Kujtim Hasan Buzra	F90826008C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
13	Jonida Faik Hunçi	I75522027N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
14	Leonard Enver Brasha	J60806018C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
15	Piro Ferit Halili	H70320023A	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	3
16	Arjan Mevlut Meta	I20327028C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
17	Nasibe Ismail Hunçi	G45229211O	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
18	Artur Isuf Guga	G80721009F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703		3,703	2
19	Lulzim Dylber Kazazi	G30612046C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	2
20	Alma Nexhat Kola	G45703011C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
21	Rajmonda Luan Zylali	I26014010H	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,940	1,288	7,228	2
22	Skenderie Petrit Xhabli	J15522025P	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,960		3,960	2
23	Bule Myhedin Kojku	H55125015N	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	7,920	1,288	9,208	3
24	Irena Agim Balazi	I65427026D	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	1,980	1,288	3,268	2
25	Mirjana Abdulla Çollaku	G76014110Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
26	Fatmira Beqir Hysa	H70522017S	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
27	Qanije Refat Brasha	F95520031H	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
28	Xhevahire Haziz Biçaku	G45120093D	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
29	Sabije Livan Zyka	F66018008Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,720	1,288	7,008	1
30	Blerina Qamil Dobrenji	I56005014U	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,940		5,940	2
31	Ramazan Tahir Brahja	G10225030V	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	2
32	Ardi Osman Elezi	I61115008U	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
33	Hyrije Adem Çota	E55210169R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
34	Aishe Sulejman Belba	G15213055C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	-00		-00	1
35	Bujar Bajram Bahidi	G80316015M	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	1,525	1,288	2,813	2
36	Albert Refat Brahja	I60413014P	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,267		3,267	2

36	Total Njësia Administrative: Librazhd			116,937	23,184	140,121	57
1	Luan Nebi Gjoci	H00401350I	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,227	1,288	6,515	3
2	Dashurije Islam Kiçi	F85303158B	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
3	Enver Mexhit Kaca	F80502085T	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	6,138	1,288	7,426	3
4	Nazif Mehmet Qostja	F90730127I	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	1,525	1,288	2,813	2
5	Zanushe Shefqet Haskurti	G76003005L	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,227	1,288	6,515	3
6	Shefije Rexhep Balazi	D55508027F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
7	Nazmi Liman Ruçi	E60228033R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	1,525		1,525	3
8	Kadife Abaz Balliu	G15710021S	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
8	Total Njësia Administrative: Orenje			29,080	5,152	34,232	17
1	Sadik Riza Zaimi	G30325115M	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
2	Shyqyri Seit Alimeta	E20222004Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	4,752		4,752	2
3	Xhevahire Islam Zaimi	G95321059Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
4	Astrit Shefqet Cura	H30624055Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
5	Bejaze Fejzulla Stërmugu	G15408018C	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
6	Farije Hamit Lleshi	E15319014U	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146		3,146	1
7	Sabrie Sadik Shata	G95605100F	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1
8	Faik Ismail Bufi	G60327051P	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	2
9	Xhevahir Kadri Doçi	H40517080G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
10	Hava Hamit Hasani	G65823039B	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
11	Imer Sali Ballolli	G30520374Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
11	Total Njësia Administrative: Polis			34,568	9,016	43,584	17
1	Fatmir Kadri Hoxha	G40320186W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
2	Fiqirete Ymer Rruplli	H85916021Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
3	Flamur Osman Dosku	G30729006Q	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
4	Isuf Jonuz Seferi	D60826014S	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
5	Sanije Shefqet Alija	G65125222I	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,940	1,288	7,228	2
6	Margarita Sami Faqolli	H75401220T	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	* 1,288	3,466	1
7	Mereme Mehmet Çerri	C75607020R	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
8	Ymer Tafil Alla	G10625082P	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,703	1,288	4,991	2
9	Tefta Asllan Hoxha	G86222012E	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178		2,178	1

10	Trandafile Sulejman Çela	H05505324G	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
11	Suzana Ramazan Almina	J45904016K	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	5,940		5,940	2
12	Khane Osman Kojku	G65105008W	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	2,178	1,288	3,466	1
13	Sanie Qamil Hoxha	G15614006P	Rekomanduar per trajtim me fondin 6 %	3,146	1,288	4,434	1
13	Total Njësia Administrative: Qender - LIBRAZHD			41,792	14,168	55,960	17
88	Totali Bashkisë			302,863	75,992	378,855	151



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD

P/VENDIM

NR ____ DATË ____/____/2025

**“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PROJEKTEVE PRIORITARE NË INFRASTRUKTURËN E
BASHKISË LIBRAZHD PËR PROJEKT BUXHETIN AFATMESEM VITIN 2026-2028”**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetqeverisjen Vendore “neni 54 pika të Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetqeverisjes Vendore “, Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimi Nr.____ datë _____.2025 “Për përgatitjen e programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028”, Këshilli i Bashkisë i mbledhur sot më datë _____.04.2025 me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd:

VENDOSI:

- I. Të miratojë listën e projekteve prioritare në infrastrukturën të Bashkisë Librazhd për vitin 2026-2028 sipas tabelës bashkangjitur.
- II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Punëve ublike, Drejtoria e Buqësisë, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Territorit dhe Pronës, Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave, Drejtoria e Buxhetit Menaxhimit Financiar dhe Shërbimi Social.
- III. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETARI BASHKISË
Mariglen Disha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT, KONTROLLIT TË TERRITORIT DHE PRONËS
SEKTORI I PROJEKTEVE DHE I ZBATIMIT TE KONTRATAVE

Lista e Investimeve Prioritare ne infrastrukturen e bashkise Librazhd per vitin 2026-2028

Nr.	Emertimi i Objektit	Vlera (leke me t.vsh)
1	Mbikqyrje Kolaudime	4,000,000
2	Studime Projektme	15,000,000
3	Shpronesime	4,000,000
4	Rikonstruksion i rrugeve rurale dhe veprave te artit te Bashkise Librazhd	52,000,000
5	Sistemim KUZ lagja Kthesa e Babjes	5,200,000
6	Ndertim Ujesjellesi ne fshatin Dragostunje	200.000.000
7	Rikonstruksion teresor dhe ndertimi i palestres se shkolles se bashkuar Orenje	82,700,474
8	Ndertim Ujesjellsi ne fshatin Funares, Nj. Orenje	30,000,000
9	Bashkefinancime me Ministrite e Linjes	30,000,000
10	Rikonstruksion dhe ngritje kati Shkolla 9-vjecare TogeZ dhe ndertimi i terreneve sportive	45,000,000
11	Rehabilitim me pyllezim i zonave te degraduara	16,000,000
12	Riparim lere betoni ne fshatrat Sebisht, Fushe Studen, Polis Gostime, Babje	3.000.000
13	Rikonstruksion teresor dhe rindertimi i palestres se shkolles se bashkuar "Vilson Blloshmi"	107,796,215
14	Rikualifikim urban Blloku banimit nr. 3 (Lagje Stacioni I Trenit), qyteti Librazhd	210,494,443
15	Rikonstruksion i cerdhes se qytetit	35,326,392

16	Asfaltim I rruges se fshatit Arrez, Njesia adm Qender	100,531,861
17	Ndertim ujesjellesi per fshatin Zdrajsh	100,000,000
18	Riparimi i digave ekzistuese te liqeneve akullnajore nr.1 dhe nr.2 Kusar" dhe "Rikonstruksion i kanalit te malit Kusar - Fushe Studen - Letem", faza 1 njesia administrative Stëblevë	100,147,684
19	Rikonstruksion i Muzeut Etnografik	35,760,221
20	Permiresimi I kushteve te banimit per komunitete te varfera dhe te pafavorizuara	58,294,544
21	Ndërtim i Poliklinikës së re në qytetin Librazhd	73,000,000
22	Ndertim impiant pastrimi i KUB	81,500,000
23	Sistemim asfaltim rruga Xhyre Qender- Xhyre Mal	188,295,413
24	Sistemim asfaltim rruga Merqize	81,500,000
25	Rikonstruksion Ujesjellesi Gurra e Bardhe – Lagje Cekrezit Hotolisht dhe Ujesjellesi Prevalle Lunik	6,213,000
26	Rehabilitim urban dhe mjedisor i perroit te Shese	50.000.000
27	Rikonstruksion ujsjellesi, fshati Vulcan, lagjia Staravec	80,000,000
28	Ndertim i rrjetit te ujesjellesit per fshatin Dardhe, Bashkia Librazhd	62,413,830
29	Rikonstruksion te segmentit rrugore te lagjes Dod-Kove Rrapi- shpia e Karajt	50,000,000
30	Mbrojtja lumore e zones perendimore te qytetit Faza III	77,192,544
31	Rikonstruksion i ujesjellesit te lagjes Albrahimi	65,000,000
32	Ndertimi i ujembledhesit te lagjes Derven	25.000.000
33	Rikonstruksion i Ambulances se fshatit Prevalle	30.000.000
34	Rikonstruksion te segmentit rrugore lagjia Isenaj, lagja Shpata	50.000.000
35	Rikonstruksion te segmentit rrugore qe lidh lagjen Troshku me fshatin Zgosht	50,000,000
36	Rikonstruksion i segmentit rrugor (Botore –Shpatadoll –	120,000,000

	Llanga) fshati Letem	
37	Asfaltim i segmentit rrugor Zgosht – fshati Letem	92.500.000
38	Blerje paisje elektronike	500,000
39	Riparime te pjeseshme ne kanalet vaditese ne bashkine Librazhd	4,500,000
40	Hidroizolimi I shkollave dhe institucioneve	5,000,000
41	Asfaltim i rruges “Maksut Kenga” dhe rruges se “Mojsjes” ne qytetin Librazhd	2,466,613
42	Blerje tuba per kanalet vaditese	2,400,000
43	Sistemim me asfaltim i rrugeve te brendshme te bashkise Librazhd ne lagjen Sheh dhe Rruga Shebeniku	8.800.000
44	Ndërtim nga e para e Zjarrëfikses Bashkia Librazhd	50.000.000
45	Rehabilitimi i shtatit të lumit Shkumbin përgjatë pritës lumore	50.000.000
46	Sinjalistika Brenda qytetit të Bashkisë Librazhd	50.000.000
47	Asfaltim i rrugës së fshatit Drabata Hotlisht, bashkia Librazhd	25.000.000
48	Asfaltim i rrugës së fshatit Mirakë Katund, Njesia Administrative Polis, bashkia Librazhd	22.000.000
49	Rruga Kokrevë Faza II	76.000.000
50	Urë Tip Baily Qarrishtë	12.000.000

Konceptoi: Adela Haskurti
Miratoi: Klodian Burgjia

KRYETARI BASHKISE
Mariglen Disha





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LIBRAZHD

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT, KONTROLLIT TË TERRITORIT DHE PRONËS

RELACION

MBI LISTEN E PROJEKTEVE PRIORITARE NE INFRASTRUKTUREN E
BASHKISE LIBRAZHD

Në bazë të udhëzimit Nr.8 datë 28.02.2025 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028” dhe në kuader të permiresimit të infrastruktures rrugore rurale të Bashkise Librazhd, zhvillimit urban, kerkesat e banoreve dhe kerkesat e administratoreve të njesive administrative jane evidentuar objektet per investime prioritare si me poshte:

Rikonstruksion i rrugeve Rurale dhe Veprave te Artit te Bashkise Librazhd

Qellimi i ketij projekti eshte rehabilitimi i segmenteve rrugore te rrezikshme ne fshatrat e bashkise Librazhd nepermjet veprave te artit dhe ndertimit te shtresave rrugore te qendrueshme pasi gjate dimrit kushtet atmosferike çojne ne amortizimin e disa prej segmenteve rrugore.

Asfaltim i rruges Funares –Zdrajsh, Loti II Njësia Administrative Orenjë

Ky segment rrugor fillon nga fshati Funarës dhe vazhdon deri në qendrën e fshatit Zdranjsh. Infrastruktura rrugore ekzistuese në këtë segment është në gjendje të amortizuar për shkak të viteve dhe mirëmbajtjes së ulët. E gjithë gjatësia e rrugës është me zhavor por faktorët atmosferikë kanë sjellë deformimin e trupit të rrugës.

Ndërtimi i shkolles 9-vjecare Togëz, Njësia Administrative Qendër - Bashkia Librazhd

Shkolla 9-vjeçare “Togëz” është ndërtuar para viteve 90 dhe nuk i është nënshtruar asnjehere ndonjë rikonstruksioni të plote. Objekti është një godinë 1 kateshe me forme drejtkëndeshi (me një thyerje në pjesën balllore). Permasa 27 m gjatësi dhe 16.1 m gjerësi. Siperfaqja e objektit është 390.2 m². Gjendja ekzistuese: dyert dhe dritaret të amortizuara, sistemi i kanalizimeve është problematik. Mungon infrastruktura sportive dhe gjelberimi. Shtresat dyshe me janë të amortizuara. Suvatimet janë të demtuara. Rrjeti elektrik nuk përballon ngarkesën. Mungon rrjeti MNZ nuk ka ambiente hidrosanitare dhe nuk ka sistem ngrohje qendrore. Nevojiten ambiente të reja për normalizimin e mesimit. Nga ky investim përfitojnë rreth 100 nxenes dhe 11 mesues që mesojnë në këto shkollë gjithashtu janë përfitues direkt të këtij investimi dhe mbi 1500 banorë të fshatit Togëz. Qellimi kryesor i projektit është që nxenesit të ndihen sa më rehat në ambientet e shkollës si brenda por edhe jashtë.

Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Mërqizë faza I Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd

Rruga e fshatit Mërqizë fillon nga rruga nacionale Elbasan-Librazhd-Prrenjas dhe vazhdon deri në qendrën e fshatit, përfshirë dhe një degëzim në të djathtë të sementit kryesor. E gjithë gjatësia e rruges është me zhavor dhe material vendi por faktorët atmosferike si reshjet ,gerryerjet e krijuara ne trupin e rruges si pasoje e mos sistemimit te ujrave te shiut kane sjelle deformimin e trupit te rruges. Gropat e shumta te krijuara ne rruge bejne qe levizja me mjet te jete e veshtire sidomos ne kohet me shi. Infrastruktura rrugore ekzistuese në këtë segment është e amortizuar per shkak te viteve qe kane qene projektuar dhe mirembajtja e ulet. Rruga në fjalë propozohet të trajtohet me gjerësi të trupit të rrugës (pjesës kaluese) 3.5 m (shtresë asfaltike), në mënyrë të tillë që të lejojnë qarkullimin normal të mjeteve të emergjencës bankina nga 0.5m në të nje anët e rrugës dhe kunete 0.5 m ne tjetren. Të parashikohet mundësia e zgjerimit në varësi të rëndësisë dhe të hapësirës. Në rastet kur nuk është e mundur zgjerimi i rrugës, të ruhet gjerësia e saj sipas gjurmës ekzistuese.

Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Kokreve faza II Njësia Administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd

Rruga ekzistuese që lidh fshatin Kokreve me rrugën kryesore është në kushte të vështira, duke krijuar vështirësi për qarkullimin e automjeteve dhe duke ndikuar negativisht në zhvillimin e zonës. Kjo rrugë është e papërshtatshme për kalimin e mjeteve të transportit, sidomos gjatë periudhave të reshjeve të shiut dhe dimrit, ku krijohen baltë dhe ujëra të grumbulluara.

Në këtë kontekst, asfaltimi i kësaj rruge do të:

- Përmirësojë cilësinë e transportit dhe qarkullimin e mjeteve.
- Lehtësojë aksesin e banorëve të fshatit dhe atyre të zonave përreth në qytetet më të mëdha.
- Ndihmojë në zhvillimin e turizmit, bujqësisë dhe tregtisë në zonë.

Asfaltim i rrugës Mirakë Plane Mirakë Katund Nj. Adm.Polis, Bashkia Librazhd

Ky segment rrugor fillon nga rruga nacionale Librazhd Elbasan dhe vazhdon deri në lagjen Hoxha. Infrastruktura rrugore ekzistuese në këtë segment është në gjendje të amortizuar për shkak të viteve dhe mirëmbajtjes së ulët. E gjithë gjatësia e rrugës është me zhavor por faktorët atmosferikë kanë sjellë deformimin e trupit të rrugës. Rruga në fjalë propozohet të trajtohet me gjerësi të trupit të rrugës 3.5 m (shtresë asfaltike), në mënyrë të tillë që të lejojnë qarkullimin normal të mjeteve. Gjatësia e rrugës është 1500 m dhe nga ky projekt përfitojnë 1000 banorë.

Rikonstruksion teresor dhe rindertimi i palestres se shkolles se bashkuar "Vilson Blloshmi"

Objekti ndodhet ne territorin adminitrativ te Bashkise Librazhd. Objekti eshte nje godine 3 kateshe me forme drejtkendeshi. Siperfaqja e gjurmes se tij eshte 582 m2 me nje siperfaqe totale 2000 m2. . Aktualisht ne shkolle mesojne 439 nxenes dhe 30 femije parashkollor, me nje staf prej 30 mesues

Pas konsultimeve dhe krahasimeve të varianteve të ndryshme nga ana e specialisteve zgjidhja më e mirë është rikostruksioni i godinës ekzistuese dhe ndertimi i një palestre të re. Kjo godinë do të plotësojë të gjitha standartet e projektimit dhe rekomandimet që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, përfshirë standartet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Gjendja ekzistuese: dyert dhe dritaret të amortizuara, sistemi i kanalizimeve është problematik. Mungon infrastruktura sportive dhe gjelberimi. Shtresat dyshe me janë të amortizuara. Suvatimet janë të demtuara. Rrjeti elektrik nuk përballon ngarkesën. Mungon rrjeti MNZ nuk ka ambiente hidrosanitare dhe nuk ka sistem ngrohje qendrore. Nevojiten ambiente të reja për normalizimin e mesimit. Qëllimi kryesor i projektit është që nxënësit të ndihen sa më rehat në ambientet e shkollës si brenda por edhe jashtë.

Rikonstruktion teresor dhe ndertimi i palestres se shkolles se bashkuar Orenje

Objekti ndodhet në territorin administrativ të Bashkisë Librazhd. Objekti është një godinë 2 kateshe me formë drejtkëndëshe. Sipërfaqja e gjurmës së tij është 548 m² me një sipërfaqe totale 1096 m². Aktualisht në shkollë mesojnë 131 nxënës dhe 22 fëmijë parashkollor, me një staf prej 27 mësues dhe edukatore. Gjendja ekzistuese: dyert dhe dritaret të amortizuara, sistemi i kanalizimeve është problematik. Mungon infrastruktura sportive dhe gjelberimi. Shtresat dyshe me janë të amortizuara. Suvatimet janë të demtuara. Rrjeti elektrik nuk përballon ngarkesën. Mungon rrjeti MNZ nuk ka ambiente hidrosanitare dhe nuk ka sistem ngrohje qendrore. Nevojiten ambiente të reja për normalizimin e mesimit. Qëllimi kryesor i projektit është që nxënësit të ndihen sa më rehat në ambientet e shkollës si brenda por edhe jashtë.

Shpronesime

Në projektet e propozuara për zhvillim në bashkinë Librazhd, ekziston prania e objekteve apo e pronave që kërkojnë shpronesim. Për të mos u bërë pengesë e zhvillimit të projektit, në rastet kur ekziston mundësia e realizimit të shpronesimit, lind nevoja e parashikimit në p/buxhet të këtij zeri. Vlera e shpronesimeve është 4,000,000 leke.

Blerje tuba për kanalet Vaditese

Sistemi vaditës duke qenë faktor kyç në bujqësi, lind nevoja për investim të herëpashershëm dhe mirëmbajtje të objekteve si kanalet vaditëse etj. Vlera e projektit është 7.,200,000 lekë.

Sistemim asfaltim rruga Xhyre Qender- Xhyre Mal

Xhyra është fshat i bashkisë Librazhd, i njësise administrative Hotolisht, me një distancë rreth qytetit të Librazhdit afro 10 km. Fshati shtrihet përgjatë lumit Shkumbin, ku vijon shtrihet në majat e shkëmbijve përreth. Në të katër stinet e vitit fshati Xhyres ofron bukuri natyrore. Zona e Xhyrës është nga ata zona që nuk është studiuar në thellësi për të njohur historinë që fshihet në këto male, por fakti që në këtë zonë gjenden gjurmë të rrugës së vjetër Egnatia e që Gjorg Golemi luftonte në këto anë në mbështetje të Skënderbeut tregon që kjo zonë ka një histori të vjetër e të pasur. Vendosja në mes të Gegërisë e Toskërisë dhe me një komunitet Gollobordas në veri të saj e bëjnë këtë kulturë të larmishme në dialekte, në veshje të ndryshme popullore e tradita. Banorët vendas si dhe emigrantë të kthyer i kanë dhënë kuptim dhe hijeshi jetës atje.

Shtëpitë e rindërtuara dhe kthimi i tyre në bujtina pritëse për turistët, është burimi kryesor i të ardhurave ekonomike. Zona e fshatit të Xhyres njihet për bujqesinë dhe blegtorinë e zhvilluar. Në fshat janë hapur bujtina ku ofrojnë ushqime tradicionale por jo vetëm pasi duke u shtrirë përgjatë rrjedhës së lumit Shkumbin nuk mungon peshku. Historiku i Fshatit Xhyre identifikohet me “Kalane e Xhyres” dhe segmentin e rrugës “Egnatia”. Rruga e asfaltuar është në gjatësinë 2 km deri në qendër të fshatit Xhyre. Segmenti I rrugës së parikonstruktuar është në gjatësinë 3 km. Kjo rrugë i shërben në mënyrë direkte banorëve të këtij fshati, janë rrugë dytësore dhe segmente që aktualisht në terren janë në kushte fizike jo të mira. Shërbejnë si rrugë kalimi për automjetet. Vështirësi paraqitet në këto segmente kryesisht gjatë muajve të dimrit ku këto akse janë kthesa të forta dhe pa bazament të qëndrueshëm.

Ndërtim nga e para e Zjarrëfikëses Bashkia Librazhd

Objekti është egzistues por nga dëmtimi që ka pësuar si pasojë e lagështirës së krijuar nga mungesa e hidroizolimit, ky objekt nuk ka kushte të përshtatëshme për tu përdorur, prandaj është menduar Ndërtim i plotë i tij.

Mbrojtja lumore e zonës perëndimore të qytetit Faza III

Ky segment është vazhdimi i Lotit II. Projekti konsiston kryesisht në krijimin e një hapësire rekreative për banorët e qytetit duke shërbyer si shetitore përgjatë bregut të Lumit Shkumbin, por njëkohësisht edhe si mbrojtje nga permbytjet që mund të shkaktohen nga lumi herë pas here për zonat përreth. Gjatësia totale e projektit është 650 m.

Konceptoi: A. Haskurti





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHË
KËSHILLI BASHKIAK

Kalendari i Konsultimeve publike për tavanet buxhetore të projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028

Këshilli Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë

Bashkia Librazhd do të informojë komunitetin mbi të dhënat për zbatimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2025, vitin 2026 në vazhdim, tavanet buxhetore përgatitore për secilin program buxhetor të PBA 2026-2028, dhe shërbimet e ofruara nga Bashkia.

Qellimi

Kërkohet opinioni i qytetarëve dhe grupeve të interesit, përfshirë grupet vulnerabel, për shpërndarjen e të ardhurave për 2026-2028 si edhe cilat janë shërbimet prioritare të komunitetit.

Grupet që do të konsultohen:

Banorët e qytetit të Librazhdit dhe të gjitha Njesitë Administrative të Bashkisë Librazhd, përfaqësues të biznesit, banoret e bashkisë përfshirë grupet vulnerabel (romë, egjiptianë) kryetarët e fshatrave, mësues, përfaqësues të organizatave jo-fitimprurese, rinisë, grupeve me aftësi të kufizuara) etj.

Kalendari

Nr	Aktiviteti	Data	Vendi	Ora	Mënyra	Forma
1	Konsultim publik me banorë, biznese, OJF, mësues, grupe vulnerabel, etj, në qytetin Librazhd	14/05/2025	Palestra gjimnazit "Ibrahim Muca"	15:00	Takim publik	Bisedë
2	Konsultim publik me banorë, Kryetare Fshatrash, mësues, etj të Njesisë Administrative Hotolisht	17/05/2025	Njësia Adm Hotolisht	10:00	Takim publik	Bisedë
3	Konsultim me banorët e Njesisë Administrative Lunik , Kryetarë Fshatrash, mësues, grupe vulnerable etj.	20/05/2025	Njësia Adm Lunik	15:00	Takim publik	Bisedë
4	Konsultim me banorët e Njesisë Administrative Orenjë , Kryetarë Fshatrash, mësues, grupe vulnerable etj.	23/05/2025	Njësia Adm Orenjë	15:00	Takim publik	Bisedë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

5	Konsultim me banorët e Njesisë Administrative Qendër Librazhd , Kryetarë Fshatrash, mësues, grupe vulnerable etj.	24/05/2025	Njësia Adm Qender Librazhd	11:00	Takim publik	Bisedë
6	Konsultim me banorët e Njesisë Administrative Polis , Kryetarë Fshatrash, mesues, grupe vulnerable etj.	28/05/2025	Njësia Adm Polis	15:00	Takim publik	Bisedë
7	Konsultim me banorët e Njesisë Administrative Stebleve , Kryetarë Fshatrash, mësues, grupe vulnerable etj.	30/05/2025	Njësia Adm Stebleve	15:00	Takim publik	Bisedë

Shënim: Ky njoftim afishohet pranë zyrave të Njesisë Administrative, publikohet online në seksionin njoftime të faqes së internetit të Bashkisë, në rubriken Keshilli Bashkiak dhe promovohet në rrjetet sociale, të paktën **10 ditë** parambajtjes së takimit të parë, dhe pas publikimit në faqen e internetit të Bashkisë Librazhd të materialeve që do të konsultohen.

Të dhëna në lidhje me raportin vjetor të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2025, së bashku me tavanet përgatitore të projekt buxhetit afatmesëm 2026 - 2028, dhe opsionet që shtrohen para komunitetit si dhe në lidhje me procesin që do të ndiqet për trajtimin e rekomandimeve, jepen në Njoftimin për Konsultimin Publik të publikuar së bashku me këtë kalendar.

Librazhd më 25.04.2025

RELACION

Mbi Projekt/Vendimin: “Për miratimin e kalendarit të konsultimeve publike”

Në zbatim të Ligjit Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” , Ligjit nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” , Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Buxhetit në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”;

Bashkia Librazhd në kuadër të hartimit të Projekt Buxhetit të vitit 2025, Buxhetit Afatmesëm 2026-2028 dhe Paketës Fiskale për vitin 2025, do të organizojë dëgjesa publike në të gjitha Njësitë Administrative me qëllim marrjen e mendimeve të qytetarëve dhe vendosjen e prioritetëve në projekt buxhet.

Buxhetimi me Pjesëmarrje (PB) është një proces demokratik e gjithëpërfshirës, i cili u mundëson qytetarëve pjesëmarrje e fuqi vendimmarrëse të drejtpërdrejtë mbi hartimin e zbatimin e buxhetit dhe shpërndarjes së fondeve lokale. Është një proces që menaxhohet nga organet vendore të qeverisjes (bashki dhe këshill bashkiak) në bashkëpunim me komunitetet lokale, i cili duhet t’u japi zë dhe adresojë çështje të rëndësishme që lidhen me komunitetet, por sidomos të sigurojë përgatitjen dhe miratimin e një buxheti publik vendor, i cili paraqet prioritetet dhe nevojat e qytetarëve (burra, gra, grupe të marxhinalizuara dhe persona me aftësi ndryshe).

Për rëndësinë që ka kjo procedurë përmbledhjet e gjithë takimeve do ti paraqiten Grupit të Menaxhimit Strategjik.

Duke ju falenderuar,

DREJTORI KABINETIT
IMELDA SINA

